



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISE KULTURES DHE INOVACIONIT
PORTI DETAR SH.A SHËNGJIN

Nr. 263 Prot.

Shëngjin, më: 8/5 / 2025

LËNDA: SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

Mbështetur në ligjin numër 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, vendimi nr.570, datë 03.10.2018 të Këshillit Të Ministrave “Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Aksionere Shtetërore”, Statutit të Shoqërisë Sh.a “Portit Detar Shëngjin” dhe relacionit të paraqitur nga Administratori I Shoqërisë dhe Këshilli Mbikqyrës mbi strukturen organizative të shoqëris Sh.a Porti Detar

Porti Detar Shengjin Sh.A shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin **JURIST** ne Drejtorin e Portin Detar Shëngjin.

Dokumentat (kriteret) duhet të paraqiten pranë Sh.A Portit Detar Shëngjin në zarf të mbyllur. Njoftimi është shpallur në faqen web: [www//portidetarshengjin.al](http://www/portidetarshengjin.al)

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme te Portit Detar Shëngjin sh.a

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

1. Të jetë shtetas shqipar.
 2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
 3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
 4. Duhet të ketë karakteristikat dhe integritet moral në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqiperise.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
 - Të mos jetë nën hetim për vepra penale

5. Të mos jetë përjashtuar me masë nga funksioni që ka kryer më parë për veprime të jashtëligjshme.

Kriteret e Veçanta:

Arsimi: Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë “Master Shkencor” në Drejtësi. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Përvoja: Të ketë jo më pak se 5 (pesë) vite experiencë pune në administratë, nga të cilat të paktën 3 (tre) vite në pozicionin drejtues.

Njohuri të tjera:

Të ketë aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit në varësi.
Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja. Përparësi u jepet kandidatëve që janë të pajisur me kualifikime, trajnime dhe dëshmi përkatëse në lidhje me këtë fushë, njohuri të mira kompjuterike.

Dokumentat (kriteret) duhet të paraqiten pranë SH.A Portit Detar Shëngjin brenda datës 22/05/2025.

DREJTOR

SANDËR MARASHI

